

Thirrje për aplikim për ekspertë të jashtëm

Detyrat

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF) monitoron punën e Strukturave për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel vendor. Në këtë kuadër në bashkëpunim me UNICEF do të hartojë një dokument “ Kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve”, siç parashikohet në Agjendën e re për të Drejtat e Fëmijës. 2021 – 2026.

ASHDMF kërkon të punësojë 2 ekspertë (1 ekspert i nivelit të lartë dhe 1 ekspert i nivelit të mesëm) për hartimin e këtij dokumenti

Ekspertët duhet të :

1. Të analizojnë kuadrin ligjor aktual lidhur me punën e NJMF
2. Të zhvillojnë intervista me persona kyc për të vlerësuar situatën aktuale
3. Të hartojnë dokumentin dhe ta pilotojnë atë në disa bashki, përpara dorëzimit të dokumentit final

Kriteret e kërkuara

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Eksperti I nivelit të lartë

- Të jenë aktualisht prej jo më pak se 7 vitesh pa shkëputje në detyrën e pedagogut në Fakultetin e Shkencave Sociale (të brendshëm ose të jashtëm) në një nga universitetet publike/private.
- Të kenë të paktën 5 vjet përvojë si ekspert në fushën e shkencave sociale me fokus fëmijët.

Eksperti I nivelit të mesëm

- Diplomë niveli Master në Shkencat Sociale ose Juridike
- Më shumë se 9 vjet eksperience dhe 4 vjet përvojë në fushën përkatëse lidhur me ceshtje me fokus fëmijët

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. CV

2. Fotokopje të diplomës;

3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dërgohet vetëm në rrugë postare në adresën: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës Rruga e Durrësit Nr 83, Tiranë

Aplikimet pranohen deri ne daten 26 nentor 2021